

VENDIM
Nr. 108, datë 19.2.2025

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR LOJËRAT MESDHETARE,
PRISHTINA 2030**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për Lojërat Mesdhetare, Prishtina 2030, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR LOJËRAT MESDHETARE,
PRISHTINA 2030

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në vijim të referuara si “Palët”,

Duke rikujtuar Kontratën për organizimin e Lojërave Mesdhetare XXI, të cilat i janë besuar qytetit të Prishtinës (në vijim e referuar si Kontrata e Qytetit Mikpritës), të nënshkruar më 8 shtator 2023, në Heraklion të Greqisë, ndërmjet Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare, Komitetit Olimpik të Kosovës, Bashkisë së Prishtinës, si dhe Republikës së Kosovës, përmes subjekteve të saj përgjegjëse, Ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës në cilësi të dëshmitarit, për të konfirmuar dhe garantuar fushat e përgjegjësisë të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës në Dosjen e Kandidaturave;

Duke pranuar përgjegjësinë e Republikës së Kosovës, si më lart, për të garantuar financimin për organizimin e Lojërave Mesdhetare XXI Prishtina 2030, siç përcaktohet në Kontratën e Qytetit Mikpritës, Kartën e ICMG-së dhe Dosjen e Kandidaturave;

Duke rikujtuar se Qeveria e Republikës së Kosovës, nëpërmjet institucioneve të saj përgjegjëse, do të ushtrojë të gjitha veprimet për të garantuar dhe lehtësuar zbatimin e dispozitave të Kontratës së Qytetit Mikpritës dhe Kartës së ICMG-së, duke iu referuar në veçanti kapitujve V-XVIII, pika 3;

Duke pranuar se Palët dhe institucionet sportive dhe bashkiake të përfshira lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi për të realizuar dhe promovuar të gjitha aktivitetet e dobishme për organizimin më të mirë të disiplinës sportive të “Lundrimit Sportiv” që me propozimin e Komitetit Olimpik Kombëtar të Kosovës dhe Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, dhe me miratimin e dhënë nga ICMG-ja, do të zhvillohet në Bashkinë e Durrësit, si pjesë përbërëse e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030,

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Objekti i Marrëveshjes

Palët bien dakord për krijimin e një kuadri bashkëpunimi për organizimin e “Garës së Lundrimit” si pjesë e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Kontratën e Qytetit Mikpritës dhe Dosjen e Kandidaturave, si dhe në përputhje të plotë me Kartën e ICMG-së.

Neni 2
Autoritetet përgjegjëse dhe zbatimi

1. Republika e Kosovës do të veprojë si Shtet Mikpritës për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030, në përputhje me Kontratën e Qytetit Mikpritës, nëpërmjet Komitetit Organizativ të Lojërave Mesdhetare (OCMG) Prishtina 2030.

2. Republika e Shqipërisë do të shërbejë si partnere e Republikës së Kosovës për organizimin e “Garës së Lundrimit” në Bashkinë e Durrësit, si pjesë e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030.

3. Palët do të bashkërendohen për të gjitha çështjet organizative dhe logjistike të nevojshme për të garantuar realizimin e suksesshëm të Garës së Lundrimit në Durrës, si pjesë e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030. Palët bien dakord të lehtësojnë komunikimin dhe bashkëpunimin efikas midis institucioneve dhe organizatave sportive përkatëse për të përmbushur të gjitha kërkesat që lidhen me organizimin e Garës së Lundrimit.

Neni 3
Përgjegjësitë e Qeverisë së Republikës së Kosovës

1. Qeveria e Republikës së Kosovës do të mbulojë të gjitha shpenzimet e ndërlidhura me organizimin e Garës së Lundrimit në Bashkinë e Durrësit.

2. Shuma financiare, sipas paragrafit të mësipërm, do të përcaktohet nga Komiteti Organizativ i Lojërave Mesdhetare (në vijim i referuar si “OCMG”), në konsultim me autoritetet përkatëse të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Bashkinë e Durrësit.

3. Qeveria e Republikës së Kosovës do të jetë përgjegjëse për transferimin e shumës financiare të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, brenda një afati të arsyeshëm kohor. Kjo transfertë do të bëhet në përputhje të plotë me parimet e transparencës, efikasitetit, integritetit, antikorrupsionit, mundësisë së barabartë dhe mos-diskriminimit, me synim garantimin e organizimit efikas, në kohë dhe profesional të sportit të lundrimit në Bashkinë e Durrësit.

Neni 4
Përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

1. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet autoriteteve përkatëse, do të jetë përgjegjës për të garantuar organizimin e suksesshëm të Garës së Lundrimit, si pjesë e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030 dhe do të zbatojë çdo legjislacion të nevojshëm që mund të kërkohej për të garantuar përmbushjen e detyrimeve që lindin nga kjo Marrëveshje, dhe duke marrë parasysh Kartën e ICMG-së, Kontratën e Qytetit Mikpritës dhe dispozitat e nxjerra nga Komiteti Ekzekutiv i ICMG-së.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të garantojë përdorimin transparent dhe të përgjegjshëm-të fondeve të pranuara nga Republika e Kosovës, duke iu përmbajtur parimeve të transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet autoriteteve të tij përgjegjëse, do të organizojë të gjitha çështjet e lidhura me sigurinë, transportin në/ dhe nga hapësirat sportive, si

dhe në hapësirat josportive të tilla si aeroporti dhe pikat tjera hyrëse/dalëse. Për këto qëllime, Kontrata e Qytetit Mikpritës do të zbatohet plotësisht në pjesën e saj dedikuar “Angazhimit të Qeverisë së Vendlut Mikpritës”, pika 2, faqe 4. Gjithashtu, ata do të organizojnë ndihmën mjekësore për të gjithë individët e akredituar, duke përfshirë kontrollet antidoping, në vijim të ndonjë vendimi të dhënë nga ICMG-ja, në përputhje me dhe në zbatim të Kartës së ICMG-së, Kontratës së Qytetit Mikpritës dhe Rregullave Antidoping të ICMG-së.

4. Për të garantuar përfundimin e duhur të procedurave të nevojshme kombëtare dhe ndërkombëtare, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të sigurojë, me të gjitha ndërhyrjet e tij të përshtatshme mbështetëse, që Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOK-Shqipëri) të iniciojë dhe të plotësojë të gjitha kërkesat për krijimin e Federatës Kombëtare Shqiptare të Llundrit, e cila do të jetë plotësisht funksionale në fund të vitit 2025.

5. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Bashkia e Durrësit janë të vetëdijshëm dhe pranojnë se:

a) Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Federata e ardhshme e Llundrit e Shqipërisë duhet të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë mbështetje për OCMG-në, lidhur me të gjitha aspektet e garave të lundrit, duke siguruar që ato të menaxhohen në mënyrë efikase dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare;

b) Bashkia e Durrësit duhet t'i dërgojë ICMG-së një deklaratë me shkrim për të pranuar përmbajtjen e Manualit të Kandidaturave me të gjitha shtojcat e tij;

c) Kontrata e Qytetit Mikpritës duhet të nënshkruhet nga Presidenti i Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Kryetari i Bashkisë së Durrësit, për garantimin e plotë të pranimit të termave dhe kushteve të Kontratës së Qytetit Mikpritës dhe pajtueshmërinë e tyre me vendimet dhe politikat e qytetit organizator;

d) Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Bashkia e Durrësit duhet të garantojnë që në vendndodhje të tjera të garës, gjatë zhvillimit të Lojërave Mesdhetare, të mos mbahet asnjë takim ose event tjetër i rëndësishëm sportiv, kombëtar apo ndërkombëtar, pa miratimin e Komitetit Ekzekutiv të ICMG-së;

e) Në organin drejtues të OCMG-së do të jenë pjesë një (1) përfaqësues i Bashkisë së Durrësit (anëtar pa të drejtë vote), një (1) përfaqësues i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (anëtar pa të drejtë vote) dhe një (1) përfaqësues i Ministrisë përgjegjëse për Sportin të Republikës së Shqipërisë (anëtar pa të drejtë vote).

6. Palët do të bashkëpunojnë për të lehtësuar procedurat e organizimit të aktiviteteve të lundrit në kuadër të Lojërave Mesdhetare 2030 dhe do të krijojnë mekanizma për të monitoruar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

7. Komiteti Olimpik i Kosovës dhe Komiteti Olimpik Kombëtar i Shqipërisë, si dhe Bashkia e Prishtinës dhe Bashkia e Durrësit, sipas kompetencave të tyre përkatëse, do të bashkëpunojnë në organizimin e sportit të lundrit, në përputhje me Kontratën e Qytetit Mikpritës, Kartën e ICMG-së, Dosjen e Kandidaturave, si dhe me këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

Neni 5

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore për hyrjen e saj në fuqi dhe do të mbeten në fuqi deri më 31.12.2031.

2. Çdo mosmarrëveshje që lind gjatë zbatimit të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhet me mirëkuptim. Në rast mosmarrëveshjeje të vazhdueshme, pala(ët) e interesuar/a do t'i paraqesin qëndrimin/et e tyre Komisionit të Etikës dhe Ligjor të ICMG-së, i cili do t'i raportojë Komitetit Ekzekutiv të ICMG-së për vendimin përfundimtar.

3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të të dyja palëve. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi nëpërmjet të njëjtës procedurë si kjo Marrëveshjeje.

4. Pas nënshkrimit nga Palët, kjo Marrëveshje do t'u transmetohet zyrtarisht palëve të tjera të interesuara të referuara në Kartën e ICMG-së për transpozimin dhe zbatimin e saj. Në të njëjtën kohë, kjo Marrëveshje do t'i transmetohet ICMG-së.

Bërë në , më..... në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe dhe angleze, të gjitha tekstet janë njësoj autentike. Në rast të mosmarrëveshjeve në interpretim, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS